



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr.14/1. prot.

Shkodër, më 14.01.2022

Or. 18/1 1204
Or. 17.01.22



Lënda: Lidhur me vendimin Nr.74 datë 23.12.2021 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejes.



KËSHILLIT TE BASHKISE VAU-DEJES

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8 germa a, ligjit Nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” ndryshuar, neni 64 germa c, Urdhërit të MB Nr.175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, Ligjit Nr.68/2017 dt.27.04.2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 17, materialit të dërguar nga Sekretari i Këshillit bashkiak Vau-Dejes Nr.7183prot dat.28.12.2021, **u njoh me vkb Vau-Dejës Nr.74 datë 23.12.2021** “Mbi miratimin e projekteve prioritare të investimeve të Bashkisë Vau-Dejës për vitin 2022”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 74, datë 23.12.2021

**“PËR MIRATIMIN E PROJEKTEVE PRIORITARE TË INVESTIMEVE TË
BASHKISË VAU DEJËS PËR VITIN 2022”**

Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të neneve 54 shkronja “k” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV”, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejes. Në mbledhjen e datës 23.12.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin e projekteve prioritare të investimeve të bashkisë Vau Dejës për vitin 2022 sipas *lidhjes nr. 1*, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Efektet e këtij vendimi janë nga data 1 janar deri në 31 dhjetor.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për marrjen e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR

Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija

Miratuar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Kundër —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 31.12.2021

